

ILIRIAN MARTIRI***AKTET E TAKIMIT VJETOR NDËRKOMBËTAR TË INSTITUTIT
“ALB-SHKENCA”, TIRANË - PRISHTINË - SHKUP, 2009***

Këshilli Botues i revistës “Aktet e Takimit Vjetor Ndërkombëtar të Institutit Alb - Shkenca” paraqiti së fundmi Vëllimin II kësaj reviste. Ky vëllim erdhi si rezultat i Takimit të Tretë të Institutit Alb - Shkenca (IASH), mbajtur në 1 - 3 Shtator 2008 në Tiranë. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues pothuajse nga të gjitha universitetet publike dhe private të Shqipërisë, nga shumë universitete të Kosovës dhe të Maqedonisë, përfaqësues të institucioneve privatet ndryshme, si dhe të organizatave qeveritare të Shqipërisë dhe Kosovës. Në të u prezantuan mbi 450 punime shkencore duke e bërë këtë takim më të madhin për nga pjesëmarrja, që është organizuar ndonjëherë në trojet shqiptare. Kjo veprimtari përbën gjithashtu edhe një nga ngjarjet shkencore më të rëndësishme për kombin për vitin 2008.

Për të mbështetur interesin e madh të kërkuesve për të botuar punimet e tyre si dhe për të përmirësuar dhe standardizuar procesin e redaktimit të punimeve sipas modeleve ndërkombëtare, Këshilli Botues i “Akteve të Takimit Vjetor Ndërkombëtar të IASH” riorganizoi strukturën e tij operative. Kështu, krahas kryeredaktorit Robert Magari, u caktuan edhe redaktorë që mbulojnë fushat kryesore të shkencës. Për shkencat albanologjike këtë detyrë e kryen Begzad Baliu (Prishtinë), Kristaq Jorgo (Tiranë) dhe Zeqirja Neziri (Shkup).

Autorët që u paraqitën në Takimin e Tretë të IASH-it patën të drejtën e dërgimit të punimeve të tyre për t’u botuar në Vëllimin II të revistës “Aktet...”. Gjithsej u dërguan 141 dorëshkrime të fushave të ndryshme të shkencës, të cilat iu nënshtruan recensimit shkencor të fshehtë prej dy recensuesve, si dhe redaktimit teknik prej Këshillit Botues. Afati i fundit i pranimit të dorëshkrimeve ishte 15 dhjetori 2008 ndërsa procesi i recensimit filloi menjëherë pas dërgimit të çdo dorëshkrimi. Këshilli Botues zgjodhi shkencëtarët më të kualifikuar shqiptarë dhe të huaj për të bërë recensimin e dorëshkrimeve dhe vendosi për botimin e punimeve në bazë të rekomandimeve të recensuesve. Në fund të këtij procesi u pranuan rreth 65% e dorëshkrimeve të dërguara të cilat u botuan në dy numrat e Vëllimit II.

IASH-i synon që “Aktet e Takimit Vjetor Ndërkombëtar” të jetë botimi me nivelin më të lartë shkencor për studiuesit shqiptarë, si dhe që ky botim të njihet në nivelin ndërkombëtar nëpërmjet faktorit të impaktit. Për këtë arsye, gjatë vitit 2009, Këshilli Botues kreu aplikimin përkatës dhe revistës “Aktet...” iu akordua një numër ISSN nga Qendra Ndërkombëtare e ISSN.

Numri I i vëllimit II, të kësaj reviste përmban të botuara kumtesa nga fushat e albanologjisë, si nga gjuhësia e sotme dhe ajo historike, nga antropologjia kulturore, historia, studimi i letërsisë, pedagogjia etj. Më konkretisht, në të janë botuar kumtesat: “Eqrem Çabej: Çështje të metodës” nga Begzad Baliu; “Universalja në poezinë e Migjenit” nga Vebi Bexheti; “Fjalori i Bashkimit’ në prizmin e gjuhës së sotme shqipe” nga Nebi Caka dhe Ali Caka; “Një përmbledhje lirikash arbëreshe e Tomazo Kamperas nga Mashkiti” nga Italo Costante Fortino; “Hapësirat ndërkufitare shqiptare - mundësi bashkëpunimi dhe integrimi në rajon” nga Dhimitër Doka; “Arsimi i lartë në Shqipëri (Promemoria “Malëshova”, 1964)” nga Çlirim Duro; “Studime të kufirit: çështja e kufirit etnik nga perspektiva e rrëfimeve personale” nga Arbnora Dushi; “Filozofia e politikës greke ndaj lëvizjes kombëtare shqiptare” nga Ledia Dushku; “Politikat gjuhësore të këshillit të Europës një sfidë për sistemin arsimor në Shqipëri” nga Andromaqi Haloçi; “Ndihmesa e studiuesve të Maqedonisë në fushën e dialektologjisë shqiptare” nga Asllan Hamiti; “Aspekte të epistemologjisë letrare shqiptare: nga konteksti i gjeopolitikës bipolare në kontekstin e integritimeve globale” nga Arben Hoxha; “Dimensioni formues i shkëmbimeve ndërkulturore në sistemin arsimor shqiptar” nga Dhurata Hoxha; “Proceset gjuhësore, identiteti kulturor dhe globalizimi” nga Mustafa Ibrahim; “Rreth pikëpamjes së Çabejt për praninë e folklorit në poemat e De Radës” nga Muharrem Jakupi; “Programet kompjuterike për gjuhën shqipe” nga Emil Lafe dhe Lulëzim Shishani; “Frazologjia – një pasuri e rëndësishme e trashëgimisë kulturore. Historiku i zhvillimit të saj dhe vlera praktike e paremiologjisë shqiptare”, si dhe “Frazologjia shqipe përballë asaj italiane” nga Irena Lama (Ndoci); “Trashëgimia kulturore - faktor i një arritjeje individuale dhe kolektive. Ligji “për trashëgiminë kulturore në Kosovë” shprehje e diversitetit dhe tolerances” nga Juliana Latifi; “Trysnia e huaj mbi shqipen standarde” nga Raul Lilo; “Një dukuri e sinonimisë sintaksore në gjuhën shqipe lidhur me përdorimin e përgjithshëm gjuhësor” nga Ilirian Martiri; “Gjella e Shën Mëris Virgjër” e Jul Varibobës: çështje të kompozicionit” nga Zeqirja Neziri; “Huazimet

në ligjërimin e specializuar (Stili juridiko - administrativ)” nga Mirela Papa; “Një fjalor i ri i termave themelorë të bujqësisë, Tiranë 2006” nga Vilma Proko (Jazexhiu); “Përvoja e Strugës në procesin e integritit gjuhësor” nga Ajtene Qamili; “Epika historike kushtuar Lidhjes shqiptare të Prizrenit” nga Gëzim Rredhi; “Albanologjia sot: shturja e paradigmës mbi vullnetarizmin shkencor” nga Shaban Sinani; “Rreth imazhit të shqiptarit në krijimtarinë artistike e publicistike të Ernest Koliqit” nga Laura Smaqi; “Fjalorët shkollorë në 100-vjetorin e Kongresit të Manastirit” nga Natasha Sotiri dhe “Mbi tipologjinë e raporteve letërsi shoqëri: rasti shqiptar” nga Hamit Xhaferi. Në numrat 2 dhe 3 të vëllimit II të revistës “Aktet...” janë botuar materiale të studiuesve nga fushat e tjera të shkencës, të mbajtura në seksionet e tjera të kësaj konference.

